



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 103 datë 30-10- 2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 25 SHTATOR 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 25.09..2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 25 shtator 2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 30-10-2025

K R Y E T A R E

Ana VERUSHI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 25 SHTATOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 24

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 24

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorë të administratës

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve mirë se keni ardhur në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, materialet janë shpërndarë, po ashtu edhe ashtu rendi i ditës, ka erdhur një kërkesë për futjen e dy materialeve në rendin e ditës, propozuar nga ekzekutivi, njëra ka të bëjë me miratimin e shtesës së planit të buxhetit prej 400.000 lekë për Festivalin Ndërkombëtar Kokofest si dhe realizimin e projektit Ekspozitë Etnografike të sponsorizuar nga Këshilli i Qarkut për këto aktivitete si dhe materiali tjetër për një propozim për ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.82 datë 28.01.2015 për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të palujtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit rikonstrukcion dhe zgjerimi i rrugës Don "Gjon Buzuku" Korçë, ka ndonjë kundërshtim nga këshilltarët në lidhje me futjen e këtyre dy materialeve, apo kërkojnë ndonjë koment nga ekzekutivi në lidhje me futjen e këtyre materialeve?

Këshilltar K.Pllaha: Unë parimisht jam kundër këtyre materialeve të futura me urgjencë ditën e mbledhjes dhe nuk kuptoj se ku qëndron urgjenca e futjes të këtyre materialeve, sepse në një nga materialet ne nuk i japim mundësi publikut të informohet sepse ne na erdhi dje pasdite si material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Bëhet fjalë për zgjerimin e Rrugës "Don Gjon Buzuku" për atë e kishit fjalën?

Po i jap fjalën drejtoreshës të financës, më pas drejtoreshës juridike.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Arsyeja me urgjencë e këtij materiali, bëhet fjalë për një financim të kryer nga Këshilli i Qarkut dhe për ta futur në Këshill duhet që këto fonde të ishin aktive në thesar të cilat janë bërë dje dhe kjo ka qënë një nga arsyet që është futur me urgjencë, por kryesorja është në bazë të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor 1936, angazhimet e reja buxhetore është afati deri në 15 tetor, prandaj në këtë mbledhje po e futim jashtë rradhe.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe një material e cila është pika 10 e rendit të ditës, që është një material për informacion për këshilltarët, ka erdhur një kërkesë të hiqet nga rendi i ditës për tu futur mbledhjen e ardhshme, me argumentimin përsëri nga drejtorja e financës.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Raporti i monitorimit do kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të buxhetit vendor, hapja e sistemit u krye para dy-tre ditësh kështu që na duhet kohë për t'i përpunuar të dhënat prandaj nuk e sollëm dot.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29 GUSHT 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 GUSHT 2025”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare A.Taho: Përshëndetje të gjithëve, për muajin gusht kemi 44 familje që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike, por nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 19 familje dhe përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor 15 familje dhe komisioni kërkon miratimin e Këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

E hedhim në votim atëherë, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, I RISHIKUAR.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës të Shqipërisë si dhe udhëzimi 19 datë 10.07.2025 të Ministrisë të Financave ekzekutivi ka dorëzuar në datën 12 shtator 2025 në Ministrinë e Financave programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 të rishikuar, burimet e financimit janë të ardhurat e veta të cilat do kenë një rritje me 0.3 % nga viti në vit, transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme e cila do ketë një rritje 5.3 % në 2026 në krahasim me vitin 2025, 5.4% në vitin 2027 krahasuar me vitin 2026 dhe 5.2 % në vitin 2028 krahasuar me vitin 2027. Gjithashtu është transfertat e pakushtëzuar sektoriale e cila do jetë në të njëjtin nivel. Theksohet se në krahasim me fazën e parë ka një ndryshim 10 milion lekë e cila është si shtesë për menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu në komision u diskutua në lidhje me rekomandimet e Ministrisë të Financave për shpenzimet e personelit dhe ato operative që të jenë në nivele të qëndrueshme dhe me tendencë rënie, në funksion, (nuk ka audio), faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Kisha disa pyetje në fakt. Së pari disa nga të ardhurat e Bashkisë janë fondet Ipa dhe ishte në tabelën e shpenzimeve si shpenzime të huaja, ka një projekt specifik, ky fond në vitin ekzistues dhe 3 vitet e ardhshme është përcaktuar?

Pyetja e dytë, një çështje që unë e kam ngritur edhe kur kemi diskutuar buxhetin, parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi infrastrukturë në ndërtimet e reja, parashikimi që është bërë në 2025 apo 2026 është pak a shumë njësoj, është 350% më e lartë sesa fakti i 2024. Do mirëkuptoja një parashikim pozitiv me shpresën se do ketë një bum ndërtimesh po nuk besoj se do kemi 3 herë ndërtime më shumë sesa kemi patur në 2024 gjatë 2025 ose nuk e di sesa është fakti në këtë 9 muaj që ka kaluar, pse është bërë parashikimi i kësaj natyre?

Dhe tjetra ne këtu kemi pasur një problematikë e cila ka kaluar në dy mbledhje faktikisht, çështja e transportit urban në një gjendje krize që e kemi mbajtur nëpërmjet shkurtimit të orareve dhe shikoj që fondi i dedikuar kësaj çështje është po i njëjti, subvencionimi prej 100 milion apo diçka tjetër, nuk ka Bashkia mundësia për ta bërë më eficient këtë shërbim qoftë edhe për ti erdhur në ndihmë operatorit që e kryen?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pyetje të tjera nga këshilltarët?

Këshilltare A.Përmeti: Në lidhje me projekt buxhetin afatmesëm si një projekt shumë i rëndësishëm strategjik por edhe menaxhimin e financave të Bashkisë kam këto pyetje, në një nga rekomandimet që ka bërë Ministria e Financave të cilën është marrë dhe përgjigje nga ana e Bashkisë është që duhet të menaxhojmë më mirë shpenzimet dhe fondin e pagave dhe të rritë atë për investime, normalisht ne nuk

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po ju jap unë përgjigje disa pyetjeve, disa Bona. Në fillim duhet të kuptojmë që po diskutojmë këtë projekt buxhetin afatmesëm, përtej diskutimeve që mund të bëjnë edhe për elementë shumë specifik edhe shumë të detajuar besoj që vëmendja dhe diskutimi kryesor duhet të jetë pak makro, në diskutim të buxheti afatmesëm, me grupe zërash, me shpërndarjen e buxhetit me grupet kryesore që janë shpenzimet për pagat, shpenzimet operative dhe investimet dhe brenda këtyre grupeve mund të ketë diskutime edhe për elementë të veçantë por jo kaq të detjuar mendoj unë deri tek vijëzimi i X rrugë tek x lagje sepse nuk i takon diskutimit të buxhetit por janë gjëra që janë të rëndësishme dhe mund t'i bëjmë si diskutim tek një pikë vetëm për to sepse hyjmë në shumë detaje dhe nuk bëjmë asgjë. Përsa i takon 3 grupeve kryesore pagat dhe shpenzimet operative, kemi pasur vitin e kaluar një rritje të pagave në zbatim edhe të ligjit përkatës për të bërë rritjen e pagave të institucione, qoftë në nivel vendor apo qoftë nivel qendror dhe kjo është reflektuar edhe tek buxheti, nuk presim të kemi rritje të tjera të ndjeshme të paktën sa rritja e vitit të kaluar. Përsa i takon pjesës të shpenzimeve operative dhe raportin e tyre me investimet e kam sqaruar edhe herë të tjera edhe për diskutimet që janë bërë për projekt buxhetin afatmesëm edhe diskutimet që janë bërë për buxhetin e vitit, siç do bëjmë edhe pas 2-3 muajsh për buxhetin 2026 dhe një pjesë e madhe e buxhetit që ndodhet në shpenzimet operative në fakt ofrojnë shërbim për qytetarët siç është shërbimi i transportit publik edhe një pjesë e këtyre zërave siç janë rikonstruksionet e trotuareve apo asfaltimet e rrugëve që realizohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike pavarisht se ne kemi zgjedhur t'i marrim si materiale dhe të përdorim kapacitetet njerëzore që kemi në ndërmarrje, në kuptimin strikt të buxhetit lexohen si shërbime operative sepse janë blerje materiale, por në fakt ato janë investime, thjesht ne i kemi hequr punojësit e ndërmarrjes ju kemi marrë vetëm materialet, nëse ne do i prokuronim me gjithë punën do ishin automatikisht në zërin e investimeve dhe janë zëra relativisht të mëdha në raport me totalin e buxhetit. Tani kishte disa pyetje në lidhje me transportin urban brenda qytetit, nuk e kuptova mirë atë pyetjen e këshilltarit Pllaha në raport me koston që kemi tani, sygjerohet ta rritim mbështetjen apo ta ulim?

Diskutimin për transportin publik e kemi bërë shumë të gjatë në momentin që kemi vendosur të bëjmë ndryshimet edhe në përzgjedhjen e operatorit edhe në kushtet e biletave, e kemi bërë shumë të detajuar edhe me këmbënguljen tuaj e kemi bërë 3-vjeçar, propozimi ynë ka qënë ta bëjmë me afat 1-vjeçar dhe të kishim mundësi ta rishikonim pas 1 viti, në kushtet e reja dhe kërkesa juaj ka qënë ta bëjmë me afat 3-vjeçar dhe diskutimet mund t'i bëjmë por në këtë hark 3-vjeçar nuk kemi se çfarë të ndryshojmë. Sygjerimet mund të na i bëni në sensin që ta rritim mbështetjen, që në kushtet që janë bilancet e operatorit të kemi një shërbim më të mirë. Rikonstruksioni i plotë dhe jo i pjesshëm i rrugëve, patjetër unë e kuptoj se çdo rrugë duhet të investohet nga fillimi dhe rikonstruktohet totalisht por në kushtet që nuk rikonstruktohen dot totalisht dhe krijohen gropa ne duhet të bëjmë mirëmbajtje të rrugëve në kuptimin jo investime të plota por zënie të gropave nuk e bëjmë vetëm ne por në çdo qytet të botës, nuk është se hapen 3 gropa dhe ja futin bëjnë rikonstruksion të komplet rrugës. Ne e kemi më të theksuar sepse infrastruktura është më e keqe krahasuar me vendet e zhvilluara Europiane dhe nevojat për investime janë të mëdha por duhet bërë edhe mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, vijëzimi i rrugës qëndron si shqetësim por nuk besoj se i takon diskutimit për buxhetin afatmesëm por nga ana e NSHP-së duhet të jenë në fazat e fundit për bërjen e procedurës për këtë vit (nuk ka audio), ku do bëhet rifreskimi i vijëzimit në ato zona ku nuk është ndërhyrë gjatë vitit të kaluar. Përsa i takon linjave tek fshatrat turistike një nga shqetësimet apo nevojat që ne duhet ta adresojmë në rast se

tavaneve kalum në fazën e dytë që po e paraqesim në Këshill dhe pjesë përbërëse e gjithë kësaj kronologjie që përmenda janë edhe fondet Ipa, këto planifikohen në bazë të parashikimeve të dhëna nga sektori i integritit për projektet, për aplikimet që ka kryer kjo drejtori tek projektet Ipa, pra është një planifikim, pasi fitohet projekti, mund të kërkohet financim si nga projekti edhe nga Bashkia, me vendim Këshilli Bashkiak paraqitet përsëri materiali dhe nga ky fond i planifikuar, kalohet në shpenzimet përkatëse që mund të jenë shpenzime operative ose fitime dhe kjo është arsyeja që planifikohen, janë pjesë përbërëse si të buxhetit vjetor ashtu edhe buxheti afatmesëm.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kush e do fjalën për diskutim?

Këshilltar K.Pllaha: Unë mendoj se është e nevojshme të përmirësohet shërbimi i transportit urban, përfshirë edhe çështje që ngrihen. Përmeti shërbimin rrethqytetas me fshatrat turistike dhe për këtë ka nevojë sigurisht për buxhet, nuk po mendoj për ndryshim kontrate pavarisht se unë e dija se ishte 1-vjeçare, qenka 3-vjeçare nuk e mbaja mend saktë dhe përmirësimi mund të kryhet edhe nga investimet që kryhen Bashkia, përshembull në shtimin e stacioneve të mirëfillta të urbanit, por edhe kur të vijë momenti edhe në ndryshim kontrate, ose në kontrata të reja me fshatrat, nëse doni të bëjmë një diskutim makro për buxhetin në tërësi ose për buxhetin afatmesëm, rekomandimin e Ministrisë të Financave kanë qënë shumë të sakta, ata vlerësojnë punën e strukturimit të të dhënave, të vlerave, mirë po kanë këtë sygjërim që thotë shpenzimet për personeli dhe shpenzimet operative janë në masën 10 % dhe 10 % investime dhe sygjerojnë që duhen ulur shpenzimet e personelit për të qënë më eficient, ju e sqaruat me të drejtë që brenda shpenzimeve të personelit ka edhe investime (nuk ka audio), për të qënë pro këtij sygjërimi që sjell Ministria e Financave nuk është e mundur që një pjesë e këtyre investimeve të tenderohen dhe të ulen më pas shpenzimet për personel, pse domethënë ky është një qëndrim im personal në fushën ekonomike me aq sa kam unë, ne po krijojmë një varësi të gjithë qytetit nga shteti, sepse kemi sa më shumë të punësuar në shtet dhe në rast se këto investime janë periodike, të vazhdueshme kryhen nga operatorë private ti si të thuash e ndihmon ekonominë e qytetit, duke ndihmuar operatorë privatë, jo duke marrë përsipër të bëjë çdo gjë Bashkia, nga ana tjetër balancon edhe ndarjen midis shpenzimeve të personelit operative dhe investimet, një këndvështrim do ishte ky sepse janë 50% shpenzime personeli, 40 % shpenzime operative, ndërkohë të ardhurat e veta të Bashkisë janë në masën (nuk ka audio), pra të ardhurat e veta nuk mbulojnë as pagat e punojësve të saj, e kam gabim këtë?

Një pjesë e punëve që bëhen nga NSHP-ja të kalojnë nëpërmjet tenderimeve tek operatorët private dhe në këtë mënyrë balancojmë edhe bilancin duke rritur investimet dhe duke ulur dhe duke zbatuar rekomandimet e Ministrisë të Financave, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kush e do fjalën prapë për diskutim?

Këshilltar E.Fejzulla: Faleminderit znj.kryetare, duke dëgjuar Klajdin po mendoja se do ishte e udhës të bëhej një përlllogaritje sa i përket kostove sepse sa ishkon Ndërmarrjes kostoja e bërjes të trotuarit për 1 M2 dhe sa do shkonte nëse kjo gjë do tenderohej pak a shumë, ose sa është nuk e di një analizë

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 24 pro, 4 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“PËR NJË SHITESË NË VENDIM NR.158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË KORÇË SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Një propozim i dërguar nga ekzekutivi për përjashtim nga pagesa e tarifës për vizitë në Kullën Paronamike i personave me aftësi të kufizuar, shkak është bërë ankesa në zyrën e mbrojtjes nga diskriminimi, komisioni vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Më fal znj.kryetare nuk e dëgjova kolegun mund ta përsërisë edhe njëherë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Patjetër.

Këshilltar A.Habip: Bëhet fjalë për një propozim që ekzekutivi ka dërguar për heqjen nga tarifave për vizitë në Kullën Paronamike për personat me aftësi të kufizuar, shkak sepse ka pasur ankesa në komisionin për mbrojtjen dhe diskriminimin.

Këshilltar I.Bode: Doja të dija nëse kemi ndonjë evidencë sa është e ardhura që ne kemi nga Kulla Paronamike dhe nëse ka ndonjë evidencë sa ka qënë % e kësaj të ardhure që kanë paguar personat me aftësi të kufizuar, gjithmonë nëse ka evidencë kuptohet?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pyetje të tjera?

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nëse është vënë në funksion ashensori sepse Kulla ka pasur një ashensor e cila me kalimin e kohës u amortizua, nga një anë ne tregohemi dashamirës dhe në gjykimin tim e meriton mbështetjen nga ana jonë, por nga ana tjetër si mund të ngjitin ata ato shkallë kur ashensori nuk punon, mos po ju hedhim hi syve me këtë vendimmarrje sa për sy e faqe apo vërtet ashensori është rregulluar dhe ne nuk kemi dijeni dhe ata tashmë mund të ngjiten në Kullë pa paguar, ju lutem ma sqaroni?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Një sqarim në lidhje me pyetjet?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ke ndonjë informacion ti Valbona në lidhje me të ardhurat?

Drejtorja e Financës V.Ziko: Jo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk kemi ndonjë informacion tani sesa janë të ardhurat që gjenerohen nga një vit, apo vizitat tek Kulla por mund ta marrim një informacion dhe ta japim mbledhjen tjetër. Përsa i takon gjendjes të ashensorit nuk është se kjo vendimmarrje është për 1 muaj apo 2, kjo është një

jenë në funksion të turizmit një zyrë e informacionit turistik, me ndonjë stacion biçikletash përshembull, janë disa ide paraprahe.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“PËR LEJIMIN E HAPJES SË DRITËS NË PRONË SHTET, ME KUSHTIN QË SUBJEKTI DO BËJË NDËRTIMIN E LULISHTES NË NJË RRUGË.

Këshilltar E.Nexhipi: Ekzekutivi të japë shpejgimin e duhur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë drejtoria e urbanistikës të japë shpejgimin për materialin, ju lutem.

Drejtoria e Urbanistikës N.Hoxha: Po bëj një sqarim në lidhje me lejin e hapjes së dritës në pronë shtet me kërkesë të qytetarit z.Andrea Filipi është bërë një kërkesë për lejin e hapjes së dritës në pronë shtet, sheshi ndodhet në Lagjen 1, Rruga “Llazo Opingari”, z.Andrea Filip ka një pasur 1/668 të cilën e ka në pronësi dhe ne kufij të tij ndodhet një truall shtet e cila është në pronësi të Bashkisë, sipërfaqja shtet është 57.9 m2 dhe ngjitur me këtë sipërfaqe kemi një rrugë të pasistemuar me sipërfaqe rreth 30 m2, nga ana e Bashkisë janë kryer verifikimet në terren dhe për shkak të konfigurimet, kuotave në sipërfaqe shtet nuk mund të ndërtojmë dot si Bashki është sipërfaqe shumë e vogël dhe kemi bërë një projekt për një lulishte dhe një rrugë e cila do bëhet me pllaka vetështrënguese, nga ana e Bashkisë është pranuar, kemi bërë propozimin për pranimin e lejit të dritës me kushtin që të ndërtohet një lulishte.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË BUSTIT TË ZAI FUNDO NË QYTETIN E KORÇËS.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit, ju lutem.

Këshilltar K.Pllaha: Më vjen mirë që po vlerësohet një intelektual, idealist por mbi të gjitha një viktimë e idealizmit, por kisha pyetje pse pikërisht (nuk ka audio), së dyti kemi shumë figura të tjera që ende nuk janë vlerësuar ende që kanë lënë gjurmë të mëdha në këtë qytet edhe që besoj se duhen nderuar me busted he mbështes z.Petri, faktin që është fyese për Këshillin kur ju e keni vendosur bustin atje dhe tani merrni miratimin tonë, por nëse ne nuk japim miratim si Këshill, (nuk ka audio).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka pyetje të tjera fjala si fillim për z.Nexhipi më pas për z.Hapib.

Këshilltar E.Nexhipi: Do bëja një koment për mua, kushdo që vlerësohet për kontributin e vetë është e rëndësishme të kemi një lloj konsensusi pavarësisht këndvështrimeve dhe nuk më duket normale që në të njëjtin moment duam ta vlerësojmë atë figurë dhe në këtë moment e njollosim me diskutime që janë fare minore të tipit kush ka mbetur për tu vlerësuar, apo pozicioni është i përshtatshëm apo jo, apo pse u vlerësua ligji, apo u pastrua një teritor publik, ju ftoj këshilltarët ta votojnë pa e humbur këtë moment të rëndësishëm që është vlerësimi i kësaj figure që ka kontribuar për këtë vend dhe jo vetëm për vendin tonë por për gjithë Evropën që ne kemi.

Këshilltar A.Hapib: Kisha diçka me z.Petri meqënëse na u drejtua si këshilltar, (nuk ka audio), nëse ne flasim se Bashkia po vendos bust tek private atëherë nuk kemi për çfarë të flasim se këtu bëhet fjalë për shkelje juridike, kjo duhet të sqarohet, nëse flasim (nuk ka audio).

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe të memories edhe aftësisë që kemi si zonë që i respektojmë ligjet, pra këtu është vendimmarrja do e vendosim apo jo bustin, kurse ky përcaktimi i kordinadës besoj është çështje e arkitektit edhe urbanastike sesa çështje e diskutimit në Këshill 1m para apo mbrapa. Përsa i përket figurave të tjera Korça është një zonë që i ka dhënë historisë të Shqipërisë në vite, ka nxjerrë disa figura të shquara me patriotë, kontributë të jashtëzakonshëm në historinë e Shqipërisë. Patjetër të gjithë meritojnë të vlerësohen dhe do vlerësohen, nuk është se vlerësimi i figurës të Zai Fundos ju mbyll rrugën apo krijon ndonjë problem me vlerësimin e figurave të tjera në qytetin e Korçës në përgjithësi, kurse ky ngatërimi i tavolinave që bllokonte zonën publike është fare pa vend, nuk ka lidhje fare, subjekti në fjalë i janë hequr tavolinat dhe karriget që i kishte në hapësirën publike sepse nuk zbatoi vendimin e Bashkisë që është administrator i zonës publike për të bërë një sistemim të kësaj hapësire.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare të lutem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të mbarojë fjalën.

Këshilltar L.Petri: Për këtë që po thotë z.kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja ta mbaroj sepse unë të dëgjova e lidhe heqjen e bustit me një subjekt për vendosjen e tavolinave i cili u soll me vendimin e Bashkisë sikur i kishim hyrë në oborrin privat dhe po i vendosnim rregulla në oborrin privat dhe besoj që individë apo subjekte të tilla duhet të kuptojnë njëherë e përgjithmonë që hapësira publike është e publikut edhe që institucioni që e administron është i përcaktuar me ligj dhe ai vendos dhe rregullat e administrimit të kësaj hapësire publike që varrojnë nga mospërdorim deri në përdorim të pjesshëm me disa kriterë të caktuara. Subjekti në fjalë ishte një subjekt i cili nuk e kuptoj se për çfarë arsye e konsideronte atë pronë private ku duhet t'i vendoste rregullat vetë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala është e hapur për diskutime dhe fjalën e ka z.Petri.

dhe tha mos u shqetëso sepse nuk ka paguar gjë Bashkia po ku e dinin ju që nuk do donin nëse do bëhej thirrje për këtë gjë?

Kur u bë luftëtari Kombëtar është bërë thirrje për këtë kontribut, (nuk ka audio) dhe është një varg nga Asdreni ku thuhet shpirtin e luftëtarëve ja u lamë trashëgimi ju të rinjve, nuk u vendos ai citat por kishte një mënyrë diskutimi që sot nuk është dhe le për të dëshiruar. Për mënyrën si po bëhet unë votoj kundër sot.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diskutime, nëse jo ju lutem këshilltarëve të votojnë, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 24 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Pika 10 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT PREJ 400.00 LEKË PËR “FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KOMEDISË, KOKOFEST”(RIKTHIM) SI DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT “EKSPOZITË ETNOGRAFIKE”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse është një financim nga Këshilli i Qarkut do doja t’ja jepja fjalën z.Nexhipi.

Këshilltar E.Nexhipi: Përshëndetje, faleminderit për fjalën Koko Fest tashmë e ka vendosur vulën e vet të suksesit por atë element që e ka gëzuar të themi qëndër qarku i mungon Bashkive të tjera që kanë mundësi të mirëpresin qarqe për këtë arsye në bashkëpunim me Zamirën vendosem së bashku me Këshillin e Qarkut që të mbështesim Koko Fest për tu mirëpritur edhe në pjesë të tjera të Qarkut Korçë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se nuk ka pyetje sepse u sqaruan që në fillim, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

PROPOZIM PËR NDRYSHIM TË VKM-SË NR.82 DATË 28.01.2015 “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË

Këshilltar E.Nexhipi: Janë krijuar disa situata konfliktit dhe mendoj se duhet të zgjidhen duke përdorur rregullat që për fat ekzistojnë, kërkesa ka të dhënat sipas ligjit. Po e depozitoj në sekretari dhe transmetoj pak tek të tjerët ju lutem. Mendoj se duhet të punojmë me këtë model edhe për zonat e tjera se vërtet po bëhet shqetësim dhe po bëhen debate.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mirela jepe sqarimin për rastin e Rabianit çfarë kemi bërë deri tani dhe cilat janë hapat në vazhdim.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Pas diskutimeve që u bë në mbledhjen e datës 29 gusht në Këshillin Bashkiak dhe problematikës që shton kjo qytetare në u morëm gjatë me zgjidhjen e këtij problem, komunikua edhe me familjen në mënyrë verbale për të cilën ngre pretendime dhe nga ana e tyre na u dha një shpjegim që kanë një familjar shumë të sëmure dhe në shtëpi shkojmë natën, ky shpjegim na u dha nga familja që zonja ngre pretendime, (nuk ka audio) e cila mund të shërbejë për zgjidhjen e situatave të tilla, nëse do vazhdojmë me hartimin e këtij dokumenti me rregullore (nuk ka audio) dhe së bashku të vendosim ose një plan masash që mund të na çojë në zgjidhjen e fenomenit. Ndërsa pretendimi i saj për t'i hequr të drejtën e banimit asaj familje dhe për të kaluar kjo zonjë tek ai apartament në kuadrin ligjor nuk përfshihet asnjë nga ligjet që parashikon zgjidhjen e kontratës para afatit nga qiradhënësit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal se dhe unë nuk e kuptova, në rastin konkret si është situata në familje?

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Bëmë komunikim verbal dhe shpjegimin na u tha se ne shkojmë natën në banesë sepse gjatë ditës rrimë me nënën që e kanë me sëmundje të rëndë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Rabian ti mund të kesh të drejtë, por komunikon në mënyrë të keqe. Tani Mirela si ma ke thënë mua, nga komunikimi që kemi bërë me Drejtorinë e Strehimit na është thënë se situata e familjeve që i kanë këto hyrje dhe nuk i përdorin nuk janë të pranueshme, pika e parë. Nuk ka një gjë të shkruar në kuadrin ligjor se cila do jetë mënyra e verifikimit dhe afatet (nuk ka audio) ka qënë që kjo të bëhet me vendimmarrje të Këshillit të Bashkisë, që do të thotë që me këtë komunikim është detyra jonë e drejtorisë të strehimit dhe e Këshillit që të bëjnë një rregullore ku të përcaktohet mënyra e verifikimit, si do e verifikojmë ne në rast se një familje e përdor apo jo, nga fatura e ujit apo e energjisë dhe e dyta cilat do jenë afatet mos përdorimit, sepse një familje mund ta ketë marrë dhe të punojë në emigracion do ja heqim këtë apartament apo jo. Pra kush do jetë periudha e mospërdorimit të apartamentit e verifikuar me fatura që e legjitimon pastaj Këshilli i Bashkisë për të marrë vendimin t'ja heqë kontratën. Ne jemi gati dhe Këshilli të caktojë një përfaqësi nga komisioni i strehimit apo ai juridik 2-3 persona sa duan këshilltarët që kanë interes për çështjen të ulen së bashku me drejtorinë të bëjnë një draft, atë draftin mirë është ta konfirmojë edhe me drejtorinë e strehimit në Tiranë mendoj unë, nga momenti që e kemi këtë kuadër ligjor fillojmë dhe e monitorojmë familjen sepse po flasim për ndërprerjen e kontratës Rabian e cila do disa kriteret sepse të hedh në gjyq ai tjetri pse ma hoqe kontratën me diskutime që ti nuk ke banuar dhe ku e vërtetove ti ose unë nuk e kam ditur thotë ai se duhet të rri gozhdë nonstop dhe nuk duhet të lëviz thotë ai. Po të fillojmë nga këto Mirela ma bëri kështu apo ashtu nuk do arrijmë në asnjë vend.

Qytetaria R.Dyli: (Nuk ka audio), unë nuk gënjej dot jam e sinqertë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pas komunikimit me drejtorinë e strehimit të dhamë të drejtë në sensin e fenomenit, në rast se ky fenomen ekziston duhet të ndërpritet por që të ndërpritet ka nevojë për disa

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio).

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe mund të bëhet kjo gjë nëse ke mundësi, por nuk është se qëndron shumë ky argumenti që edhe ne edhe fëmijët po luajnë në të njëjtat lojra, ajo është tjetër gjë. Qëllimi i kësaj ndërhyrje ishte që ai kënd lojrash me buxhete jo të mëdha të bëhej funksional duke eliminuar në rradhë të parë llojet e rrezikshmërive, megjithatë po e bëj dhe një verifikim të llojit të ndërhyrjeve dhe në rast se e shohim që janë ndërhyrje që kanë një lloj problematike këtë të tapetit ta verifikojmë ose nuk arrijmë të shmangim rrezikshmëritë edhe mund të shohim për një lloj ndërhyrje tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Atëherë shumë faleminderit.

Qytetaria R.Dyli: (Nuk ka audio).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Rabian e diskutuam edhe njëherë, do ndërtojmë këtë që thamë pastaj do bëhen verifikimet, nuk do ketë me ditë të përcaktuara atje në rregullore se kur do ju vemë atyre. Faleminderit, shihemi mbledhjen e rradhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

